

KLASA VIRTUALE E ZOTIT LEE



Autorët
Genesis Capellan & Bekim Bruka
Justin Diaz & Paige Kim

Ilustrimet
Diana Melo

Përmbledhja

Klasa e parë është një periudhë shumë emocionuese. Por çfarë ndodh nëse dita e parë e shkollës është online? Klasa virtuale e Zotit Lee flet për një grup nxënësish të klasës së parë të cilët e kalojnë ditën e parë të shkollës nëpërmjet programit Zoom. Klasa e zotit Lee ka 9 nxënës të mrekullueshëm, ku gjithësecili prej tyre ka një histori për të treguar rreth kulturës së vet.

Kjo histori tregon se si fëmijë nga rrugë të ndryshme të jetës janë përshtatur me COVID19 dhe botën virtuale. Ndërkohë që fëmijët diskutojnë për kulturën e tyre dhe mësojnë më shumë rreth njëri-tjetrit, ata fillojnë dhe kuptojnë domethënien e diversitetit dhe çfarë i bën njerëzit të ndryshëm. Zoti Lee i ndihmon nxënësit e tij të

Kontribuesit

Autorët

Genesis Capellan

Bekim Bruka

Justin Diaz

Paige Kim

Ilustrimet

Diana Melo

Përkthimet

Shqip - Bekim Bruka

Koreane - Paige Kim

Portugalisht - Raquel Dos Santos

Spanjisht - Luz Mildred Tito

Gjermanisht - Kayla Thomas

Italisht - Luz Mildred Cusi Ttito



Zoti Lee jep mësim në një klasë të parë virtuale.

Klasa virtuale nënkupton kur të gjithë nxënësit bëjnë mësim nga kompjuteri në shtëpinë e tyre.

Zotit Lee i mungojnë takimet me klasën e tij, por mësimi virtual është mënyra më e mirë për të mbajtur njerëzit e sigurtë nga pandemia.

Edhe pse mësimi nuk jepet në shkollë, të gjithë mund të shihen në ekran.

Zoti Lee përshëndeti klasën:

- Mirmëngjesi të gjithëve! Jam shumë i lumtur që ju shoh të gjithëve! Përpara se të nisim mësimin, është e rëndësishme të dimë më shumë rreth njëri-tjetrit. Sot, ne do të diskutojmë për traditat tona.





Iliri ishte pak i hutuar, prandaj ai pyeti:

- Zoti Lee, çfarë është tradita?

- Më bëhet qejfi që pyete Ilir! Tradita është diçka e veçantë, si për shembull një festë që ne e bëjmë me familjen tonë në shtëpi, - tha zoti Lee.

- Gjithësecili ka stil të ndryshëm jetese. Ne mund ta kuptojmë këtë duke parë edhe në dhomat e secilit. Ling ka dhomë rozë, Nadia ka dhomë jeshile, dhe Markus ka dhomë të verdhë. Ato kanë ngjyra të ndryshme, por dhomat sërish janë dhoma.





Ling u ngazëllye dhe tha:


- Sa bukur! A mund të ndaj me ju se çfarë bëj unë me familjen time?

- Patjetër Ling! - tha zoti Lee. - Por si fillim, unë dua t'u jap të gjithëve një detyrë. Do ju lë 15 minuta kohë që të vizatoni një veprimtari tradicionale që ju bëni me familjen tuaj. A mund ta bëni?


Nxënësit pohuan me kokë dhe thanë:

-Po!

- Epo mirë, le të fillojmë!



YES!



Pas 15 minutash, zoti Lee të u tha gjithëve që të ndërprisnin së vizatuari.

- Koha mbaroi! Ling, meqë me mirësjellje kërkove të na tregosh pak më parë, do të të lejoj të vazhdosh i pari.



Ling tha:

- Unë vizatova për festivalin e Qingming, që është një ditë e veçantë në Kinë.


- Ling, përse nuk na tregon më shumë për këtë festë? - pyeti zoti Lee.



Ling shtoi:

- Në këtë ditë, ne bëhemi bashkë dhe pastrojmë varret duke kujtuar paraardhësit tanë.

Gjithashtu, ne shijojmë ngjyrat e para të pranverës. Unë ngula një lule të bardhë tek varri i stërgjyshes time. Mamaja ime thotë se këtë e bëjmë për të nderuar stërgjyshen.





Pasi dëgjoji historinë e Ling, Iliri buzëqeshi me ngazëllim.


- Në vendin tim ka një festë të ngjashme.

- E mrekullueshme! A mund të na tregosh më shumë për këtë festë, Ilir? - pyeti zoti Lee.

- Në vShqipëri ne e festojmë fillimin e pranverës duke zbukuruar ballkonet me lule. Ne gatujmë dhe disa biskota të veçanta që ne i quajmë Ballokume.

Fëmijëve u pëlqeu shumë historia e Ilirit, madje tani donin edhe biskota.





Më pas Edeni foli.

- Mësues, a mund të flas? A mund të jem i rradhës?

- Patjetër, Eden! A mund të na e tregosh se çfarë ke vizatuar të lutem?!

- Unë vizatova Vitin e Ri të Pemës në Izrael, që ne e quajmë Tu b'Shevat. Në këtë ditë unë, mami, dhe babi mbjellim një pemë në mënyrë që të mbrojmë mjedisin.

**- Një vizatim i mrekullueshëm Eden!
Faleminderit shumë që vendose ta ndash me ne!
Kujdesi për mjedisin është tejet i rëndësishëm,
- shpjegoi zoti Lee.**

Nadia ishte e mrekulluar nga vizatimet e shokëve dhe shoqeve të klasës. Ajo ngriti dorën e ndrojtur që të tregonte vizatimin e saj.

Zoti Lee vuri re se Nadia kishte ngritur dorën dhe pyeti:

- Nadia, a mund të na tregosh se çfarë ke vizatuar të lutem?

- Këtu është Sham El-Nessim, një festë që mirëpret pranverën në Egjipt. Në këtë ditë njerëzit shkojnë në parqe dhe shikojnë natyrën me admirim. Ne gjithashtu kërcejmë së bashku dhe kënaqemi shumë.

- E mrekullueshme!







- Tjetri në rradhë është Hektori. Hektor, çfarë ke vizatuar? - pyeti zoti Lee.


Hektori fillimisht hezitoi, por më pas tha:

- Ummm..unë kam vizatuar një darkë të veçantë me familjen që bëhet çdo vit.

- Cila është veçantia e kësaj darke?

- Mamaja më ka thënë që kjo darkë bëhet në nder të familjarëve tanë që nuk jetojnë më. Në spanjisht ne e thërrasim “Dia de Los Muertos” këtë ditë.

Hektori qeshi duke parë vizatimin dhe u tregoi shokëve e shoqeve të klasës që kjo darkë i kujtonte gjyshen e tij që dikur jetonte në Guatemalë.






Oliveri vazhdoi më pas.

- Po! Prindërit e mi janë nga Australia. Çdo vit ne shkojmë në Australi dhe festojmë festivalin e Tjungu. Familja ime organizon një festë të madhe. Ne ngjyrosim trupat tanë dhe veshim rroba të bukura.

- Çfarë nënkupton kjo festë? - pyeti zoti Lee.

- Ne festojmë traditat e paraardhësve tanë në mënyrë që të nderojmë kulturën që ata na kanë trashëguar.



- Kjo është e mahnitshme Oliver! Kush dëshiron të jetë i rradhës? - pyeti zoti Lee.

Zonja Xheni, përkthyesja e Alishas, foli për vizatimin e saj:

- Zoti Lee, Alisha dëshiron të tregojë për vizatimin e saj gjithashtu.

- Patjetër!








- Alisha thotë që në shtëpinë e saj në Indi, familja e saj ka një festival që i mbledh njerëzit bashkë. Festivali quhet Diwali, ku ndizen shumë qirinj dhe vendosen rreth e rreth qytetit. Alisha thotë se kjo festë i dedikohet mirënjohjes për shëndetin dhe lumturinë, - shpjegoi zonja Xheni.

- Më pëlqen shume Alisha! Është tejet e rëndësishme që të jesh falenderues. Faleminderit zonja Xheni!




Papritur Xhefri tha plot ngazëllim:

- Unë kam vizatuar një maskë! Unë kam vizatuar një maskë!

- Maska është e bukur! Çfarë nënkupton ajo Xhefri?

- Njëherë babai më çoi në Itali dhe aty festuam Karnavalet. Është një festë ku gjithësecili bën masken e vet dhe feston të qenit bashkë me të tjerët. A ju pëlqen maska ime zoti Lee?




- Është një maskë e mrekullueshme dhe me ngjyra të bukura. Faleminderit që e ndave me! Markus, është rradha jote.

Markusi ishte shumë i lumtur që ishte i rradhës për të treguar.

- Mirë! Unë kam vizatuar për festën e “Juneteenth.” Në këtë ditë unë dhe familja ime festojmë ditën e lirisë të paraardhësve të mi. Ata kanë qenë skllëvër. Ne i nderojmë dhe përkujtojmë sepse ata kanë qenë shumë të fortë.

- Uau! Kjo është shumë prekëse Markus.



Pasi gjithësecili ndau historinë e vet, fëmijët u lumturuan shumë.

Ata qeshën me njëri-tjetrin dhe filluan të drejtonin gishtin nga vizatimet e tyre.

Fëmijët u kënaqën shumë duke dëgjuar për jetën dhe kulturën e njëri-tjetrit.

- Faleminderit të gjithëve që e ndatë kulturën tuaj me ne! Tani unë do të shpërndaj ekranin tim, por përpara se ta bëj dua vëmendjen tuaj. Sot të gjithë ju mësuat se njerëzit vijnë nga kultura dhe vende të ndryshme, madje dhe festivalet i festojnë ndryshe. A nuk është e mrekullueshme kjo gjë?!

Fëmijët pohuan plot gëzim:

– Po!

Hektori brohoriti:

– E mrekullueshme!


Ndërkohë Edeni me qetësi tha:

– Më pëlqeu shumë të dëgjoja për historitë tuaja!

– Jam i lumtur që ju të gjithë u kënaqët nga ky aktivitet. Është e rëndësishme të kuptojmë që të qenit ndryshe është diçka e bukur. Tani, merrni një laps me ngjyrë ju lutem!



YES!



- Nëse gjithësecili prej nesh do merrte një laps dhe të vizatonte i vetëm duke përdorur vetëm një ngjyrë, vizatimi nuk do të kishte gjallëri. Por nëse gjithësecili prej nesh do të përdorte ngjyrën e vet për të bërë një vizatim të përbashkët, do të dukej jashtëzakonisht i bukur, apo jo?

Fëmijët pohuan me gëzim, dhe brohoritën:

- Po! Do të ishte shumë i bukur!

Më pas, zoti Lee ndau ekranin e tij.



Të jesh ndryshe është diçka e bukur. Dhe kur ne jemi së bashku të ndryshëm, ne jemi si një ylber në qiell.

Fundi.

